



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 967/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Gjakovë, paraqitur kundër Aleancës për Ardhmërin e Kosovës (AAK), për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor të raundit të dytë gjatë zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Aleancës Kosova e Re (AKR), dega në Gjakovë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 01.12.2013, nga ana e subjekti politik AKR ,dega në Gjakovë, në të cilën pretendohet se aktivistët e subjektit politik AKR në Gjakovë kanë fotografuar njoftime të vendosura nga ana e aktivistëve të AAK-së në rrethojën dhe afër saj në qendrën e vendvotimit Bajram Curri në Gjakovë, rruga Ismail Qemali. Sipas parashtruesit të ankesës është bërë shkelje e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë (LZP) si dhe Kodin e Mirësjelljes.

PZAP-i, e informoi subjektin politik AAK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 02.12.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 03.12.2013, në ora 12:00.

PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik AAK sipas afatit të caktuar,deklaron se vendosja e njoftimit në rrethojën e qendrës së votimit me datë 28 nëntor nuk paraqet shkelje dhe AKR ka manipuluar dhe e ka paraqitur si shkelje ditën e votimit. Përgjigja në ankesë ka të bashkëngjitur Udhëzimin e Kryetarit të AAK-së drejtuar të gjitha strukturave të AAK-së për respektimin e ligjit mbi zgjedhjet dhe rregulloreve të KQZ-së të datës 21 gusht 2013 dhe kërkesën e drejtuar shefave të shtabeve zgjedhore për respektim të Kodit zgjedhor të datës 04 tetor 2013.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *“Mund te apeloohen vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikojë cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

Pretendimet ankimore se aktivistët e AAK-së në Qendrën e Vendvotimit Bajram Curri në rrethojën e saj kanë vendosur njoftime, nuk qëndrojnë sepse nga fotografit e ofruara nuk janë dëshmi bindëse për të vërtetuar se janë të vendosura njoftimet të supozuara në ankesë, me këtë rast vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar dhe nuk mund të vërtetohet shkelja e supozuar. Andaj, PZAP-i konstaton se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartëpërmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 967/2013 më datën 04.12.2013



Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda 24 (njëzetekatër)orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.